



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

PRIZREN

Lajmërim

për regjistrimin e fëmijëve në Kopsht

Nga data **22 korrik 2020**, fillon regjistrimi i fëmijëve (3-6 vjeçar) në Kopshtin Publik në lagjen “**11 Marsi**” pranë shkollës fillore “Lekë Dugagjini”, në Prizren.

Regjistrimi i fëmijëve bëhet çdo ditë pune nga ora **10:00 – 15:00**. Numri i fëmijëve, të cilët mund të regjistrohen në kopsht është gjithësejt 160 (120 fëmijë në gjuhën shqipe dhe 20 në gjuhën boshnjake dhe 20 në gjuhën turke). Afati i fundit për regjistrim është data **20 gusht 2020**.

Kopshti ka staf profesional, të përgatitur për ofrimin e gjitha shërbimeve edukative, kognitive (njohëse), emocionale dhe shëndetësore (edukatorët e kualifikuara, pedagogun, psikologun, dhe mjekun). Raporti edukatore-fëmijë është 2:22. **Qëndrimi i fëmijëve në kopsht është tërëditor.**

Çmimi për fëmijë: një (1) fëmijë = 80 euro në muaj, dy (2) fëmijë = 120 euro dhe tre (3) fëmijë 150 euro. Në çmim janë të përfshirë: kujdesi, edukimi-mësimdhënia, ushqimi, materiali mësimor- didaktikë, aktivitetet e shumta muzikore, rekreative, etj.

Fëmijët, të cilët vijnë nga familjet në asistencë sociale, fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët e braktisur dhe pa përkujdesje prindërore, fëmijët që jetojnë me një prind dhe fëmijët e veteranëve të luftës, janë të liruar nga pagesa e tarifës së lartëshënuar. Përparësi do të kenë fëmijët e nënave të punësuar.

Dokumentacioni për regjistrim:

- Aplikacioni (merret në momentin e regjistrimit të fëmijut në kopsht);
- Çertifikata e lindjes së fëmijut;
- Dëshmi nga mjeku për gjendjen shëndetësore të fëmijut;
- Dëshmi për vaksinimin e fëmijut (fletorja e shëndetit të fëmijut);
- Adresa e banimit të fëmijut-familjes;

Pas regjistrimit të fëmijut në kopsht, prindi përkatësisht kujdestari ligjor i fëmijut dhe stafi i autorizuar i kopshtit, nënshkruajnë kontratën e bashkëpunimit, me të cilën specifikohen obligimet kontraktuale të të dy palëve.

Suksese!

TË GJITHË SËBASHKU PËR EDUKIM DHE ARSIM CILËSOR